VENDIM
Nr.599, datë 1.10.2007

PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE
"RADIO KISS"
SUBJEKTIT: KISS SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në periudhën maj-qershor 2007, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat vendor subjektin KISS sh.p.k., radio private vendore "Radio Kiss", pasi në dokumentacionin e paraqitur mungonin:
a) Garancia bankare;
b) Vërtetimi i zyrës së regjistrit tregtar;
c) Deklarata e vërtetësisë së të dhënave të paraqitura.
2. Subjekti sipas pikës 1 të vendimit, mund të ankohet në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)